




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE PRIVAT
SHOQËRIA PËRMBARIMORE PRIVATE
“HOTI BAILIFF SERVICE” SH.P.K

QENDRA KOMBËTARE
E BIZNESIT
Nr. 11681 Prot.
Datë 23.12.2020



Nr. 4518/2 Prot

Durrës, më 18.12.2020

URDHËR
PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Biznesit --- Tiranë.

Drejtuar Debitorit : Shoqëria “ALBA Cosmetic 2014”shpk NUIS L42224502H

Për dijeni Kreditori : Selman Dyrmishi

Unë Hasan Zela Përmbarues Gjyqësor Privat bazuar në Urdhërin e Ekzekutimit Vendimin Nr. 1110, datë 04.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës.

KONSTATOVA

Se në datë 18.12.2020 është depozituar pranë Shoqërisë Përmbarimore Private “Hoti Bailiff Service” sh.p.k kërkesa e kreditorit **Selman Dyrmishi**, së bashku me urdhërin e ekzekutimit, lëshuar për titullin ekzekutiv Deklaratë Noteriale Nr. 2239 Rep dhe Nr. 1661 Kol, datë, 18.12.2015 „, me palë;

-Kreditor: Selman Dyrmishi

-Debitor : Shoqëria “ALBA Cosmetic 2014”shpk NUIS L42224502H” me administrator Adi Mehmeti.

-Objekti : Kthim shume

Në kushtet kur për ekzekutimin e Urdhërit të Ekzekutimit, është vendosur Ekzekutim i Detyrueshëm dhe duhet të vihet sekuestro mbi aksionet/kuotat e palës debitore; Shoqëria “ALBA Cosmetic 2014”shpk NUIS L42224502H” me administrator Adi Mehmeti., me qëllim pengimin e ndyshit të statusit dhe shitjen e kuotave/aksioneve të palës debitore.

Në zbatim të neneve 519 e në vijim të K.Pr.Civile, të ligjit Nr.26/2019 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Privat”

URDHËROJ

1- Qendrën Kombëtare të Biznesit – Tiranë të vendosi masës e sekuestros konservative mbi aksionet/kuotat e palës debitore; Shoqëria “ALBA Cosmetic 2014”shpk NUIS L42224502H” me administrator Adi Mehmeti., me qëllim pengimin e ndyshit të statusit dhe shitjen e kuotave/aksioneve të palës debitore

2- Për veprimet apo mosveprimet tuaja , na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.

3- Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobes dhe kallzimin penal.

4- Ky urdhër mbahet në disa kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5 ditëve.

PËRMBARUES GJYQËSOR
HASAN ZELA